



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 166

Tiranë – E mërkurë, 17 shtator 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 496, datë 10.9.2025	Për miratimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, dhe Qeverisë së Shtetit të Izraelit, përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes e Shtetit të Izraelit, në lidhje me kapacitetet mbrojtëse.....
	21403
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 10.9.2025	Për miratimin e letërmarrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Përmirësimi i praktikave të kontabilitetit dhe raportimit të sektorit publik në Shqipëri”.....
	21408
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 867, datë 9.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Letonisë.....
	21414
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 868, datë 9.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Polonisë.....
	21416
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 869, datë 9.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Spanjës.....
	21419
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 870, datë 9.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Portugalisë.....
	21420
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 871, datë 9.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Bullgarisë.....
	21421

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 877, datë 11.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Hungarisë.....	21423
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 878, datë 11.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Sllovenisë.....	21425
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 879, datë 11.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Kroacisë.....	21427
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 880, datë 11.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Italisë.....	21429
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nr. 419 (2399), datë 10.7.2025	Për heqjen e zotësisë juridike për të vepruar të shtetasit Dritan Pjetri	21431



VENDIM

Nr. 496, datë 10.9.2025

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
KUADËR NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E MBROJTJES E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DHE
QEVERISË SË SHTETIT TË IZRAELIT,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
MBROJTJES E SHTETIT TË IZRAELIT,
NË LIDHJE ME KAPACITETET
MBROJTËSE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, dhe Qeverisë së Shtetit të Izraelit, përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes e Shtetit të Izraelit, në lidhje me kapacitetet mbrojtëse, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE KUADËR

NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË EMËR
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
MINISTRISË SË MBROJTJES SË SHTETIT TË
IZRAELIT NË EMËR TË QEVERISË SË
SHTETIT TË IZRAELIT NË LIDHJE ME
KAPACITETET MBROJTËSE

PREAMBULË

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (në vijim e referuar si “AMOD”);
dhe

Ministria e Mbrojtjes e Shtetit të Izraelit, në emër të Qeverisë së Izraelit (në vijim e referuar si (“IMOD”);

Duke marrë në konsideratë Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Shtetit të Izraelit për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, të nënshkruar në Tel Aviv më datë 26 qershor 2023 (në vijim i referuar si “**Memorandumi i Mirëkuptimit për Bashkëpunimin në Mbrojtje**”);

Duke marrë në konsideratë vendosmërinë e ndërsjellë të Palëve për të zhvilluar një **partneritet strategjik afatgjatë**, duke nxitur bashkëpunimin e ndërsjellë në fushën e prodhimit të mbrojtjes, ndarjes së teknologjisë dhe kapacitetet operacionale;

Duke rikonfirmuar interesin e tyre të përbashkët dhe gatishmërinë reciproke për të zhvilluar dhe forcuar marrëdhëniet në drejtim të zbatimit të kapaciteteve mbrojtëse nëpërmjet transferimit të teknologjisë, sipërmarrjeve të përbashkëta dhe nismave për zhvillimin e kapaciteteve;

Duke marrë në konsideratë gatishmërinë e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë për të ndërmarrë procesin e **montimit dhe integritimit operacional** të kapaciteteve të mëposhtme në Shqipëri, siç është rënë dakord nga Palët:

1. Sistem i armatimit të vetëkomanduar të montuar në automjet (**ATMOS**) – Obuz lëvizës 155 mm, kalibër 52;

2. Sisteme mortaje të montuara **SPEAR** –120 mm;



3. Platforma kuadkopter (lloj helikopteri me katër helika);

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje Kuadër (MK), termat dhe akronimet e mëposhtme kanë këto kuptime:

<i>Shoqëri shqiptare</i>	Kayo sh.a., Shoqëri Shtetërore e Mbrojtjes.
<i>Furnizues Industrial</i>	Elbit Systems Land Ltd ose Elbit Systems C4I and Cyber Ltd (siç është e zbatueshme).
<i>Kontratë</i>	Kontrata e parë, kontrata e dytë ose kontrata e tretë (sipas rastit), e cila përbën marrëveshjen tregtare ndërmjet IMOD-it, Furnizuesit Industrial dhe Shoqërisë shqiptare për zbatimin e kapacitetit përkatës të rënë dakord në këtë Marrëveshje Kuadër.
<i>Kapacitet</i>	Kapaciteti 1, kapaciteti 2 ose kapaciteti 3.
<i>Kapaciteti 1</i>	ATMOS – Obuz lëvizës 155 mm, kalibër 52, i blerë, i montuar përfundimisht në Shqipëri dhe i dorëzuar në përputhje me kushtet e Kontratës së Parë.
<i>Kapacitet 2</i>	SPEAR – Sistem mortaje i montuar 120 mm, i blerë, i montuar përfundimisht në Shqipëri dhe i dorëzuar në përputhje me kushtet e Kontratës së Dytë.
<i>Kapacitet 3</i>	Thor ISR dhe Magni-x Systems (“Kuadkopterët”) dhe produktet dhe sistemet përkatëse. Montimi i kuadkopterëve do të realizohet në Shqipëri, me përjashtim të dhjetë (10) platformave të para, të cilat do t’i dorëzohen AMOD-it si sisteme të plota funksionale për qëllime trajnimi, të gjitha në përputhje me kushtet e Kontratës së Tretë.
<i>Garantimi i Cilësisë nga Qeveria (GQA)</i>	Procesi sipas të cilit SIBAT, një departament pranë IMOD-it që mbikëqyr kryerjen e transaksioneve ndërkombëtare në nivel GTG-je, siguron që Furnizuesi Industrial të përmbushë kërkesat e cilësisë të përcaktuara në Kontratën nga Shteti i Izraelit, me kusht që këto kërkesa cilësie të lidhen me aktivitetet e cilësisë të IMOD-it në territorin e vet kombëtar për kapacitetet mbrojtëse të prodhuara dhe të ngjashme me ato të marra në kuadër të programeve të veta kombëtare, sipas metodave të veta në fuqi.
<i>Informacion</i>	Çdo informacion i përdorur në lidhje me këtë Marrëveshje Kuadër (MK), i çfarëdo lloji dhe në çfarëdo forme.
<i>Komitet Monitorimi (MC)</i>	Komiteti i ngritur nga Palët për të monitoruar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Kuadër.
<i>Personel</i>	Anëtarët e personelit kuptohen si personel që u përket njësive dhe formacioneve të forcave të armatosura dhe çdo strukture tjetër ushtarake, shërbimesh mbështetëse ose organizatave të përbashkëta të ndonjërës Palë, si dhe personelit civil të ndonjërës Palë, të përfshirë për të marrë pjesë në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Kuadër.
<i>Mbështetje</i>	Mbështetja e zbatuar nga IMOD, me kërkesë të AMOD-it, në përputhje me këtë Marrëveshje Kuadër, bazuar në përvojën e fituar nga IMOD-i, siç përcaktohet në paragrafin 3.1 të nenit 3 të kësaj MK-je.
<i>Palë e tretë</i>	Çdo individ ose person juridik tjetër përveç Palëve.



Neni 2

Qëllimi dhe fushëveprimi

2.1. Kjo Marrëveshje Kuadër (MK) synon përcaktimin e parimeve dhe procedurave që lidhen me mbështetjen e ofruar nga IMOD për AMOD-in, për zbatimin e kapaciteteve mbrojtëse dhe detyrimeve ndërmjet Palëve.

2.2. Dispozitat e kësaj MK-je nuk rregullojnë, zëvendësojnë apo ndryshojnë detyrimet dhe angazhimet e IMOD-it, AMOD-it, Shoqërisë Shqiptare dhe Furnizuesit Industrial të përcaktuara në Kontratë.

2.3. Aktivitetet e përcaktuara në këtë MK do të zbatohen në përputhje me rregulloret dhe legjislacionin kombëtar përkatës, si dhe me detyrimet ndërkombëtare përkatëse të secilës Palë.

2.4. Mund të vendosen Marrëveshje Zbatuese shtesë ndërmjet Palëve, kur të jetë e nevojshme.

2.5. Shoqëria shqiptare do të shërbejë si palë kontraktuese për të nënshkruar dhe zbatuar të gjitha aktivitetet në kuadër të Kontratës.

2.6. AMOD-i është e detyruar dhe mban përgjegjësinë e plotë dhe të pakushtëzuar për drejtimin dhe zotërimin e të gjitha aktiviteteve të mbuluara nga kjo Marrëveshje Kuadër.

Neni 3

Angazhimet e Palëve

3.1. Me kërkesë të AMOD-it, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të Kontratës, IMOD-i angazhohet:

- Të monitorojë zbatimin e Kontratës nga ana e Furnizuesit Industrial, në lidhje me Kapacitetin;

- Të lehtësojë diskutimet ndërmjet Shoqërisë Shqiptare dhe Furnizuesit Industrial, në rast të problemeve teknike ose mosmarrëveshjeve që lidhen me kapacitetin, për sa i përket zbatimit të Kontratës;

- Nëse kërkohet nga AMOD-i, të kryejë në shtetin e Izraelit, në momentin kur Kapaciteti është gati për dorëzim, aktivitetet e Garantimit të Cilësisë nga Qeveria (GQA) për aspektet teknike të Kapacitetit, në përputhje me metodat në fuqi të përdorura nga furnizuesit industrialë për programet izraelite, si dhe të nënshkruajë certifikatën e konformitetit, sipas Deklaratës për Garantimin e Cilësisë nga Qeveria, sipas rrethanave.

3.2. AMOD-i angazhohet:

- Të sigurojë që shoqëria shqiptare të përmbushë të gjitha detyrimet e saj, siç parashikohet në Kontratë, në përputhje me skedulën dhe karakteristikat e përcaktuara në të, dhe të furnizojë ose të vendosë në dispozicion në kohë të gjitha kapacitetet, informacionin, shërbimet, lejet dhe infrastrukturën e nevojshme, siç përcaktohet në Kontratë, për të mundësuar që Furnizuesi Industrial të përmbushë detyrimet e veta;

- Të përfshijë në Kontratë kushtet për përfshirjen e IMOD-it në kryerjen e aktiviteteve të Garantimit të Cilësisë nga Qeveria (GQA), në lidhje me kapacitetin, të gjitha siç është rënë dakord në Kontratë;

- Të jetë autoriteti i vetëm përgjegjës për pranimet (rishikime, dokumentacion etj.), verifikimet, kualifikimet, vendimet përfundimtare për pranimin, kalimin e pronësisë (shërbime, kapacitete, dokumentacion etj.) të Kapacitetit, dhe për hartimin e çdo dokumenti kontraktual shtesë;

- Të trajtojë, me shpenzimet dhe përgjegjësinë e saj të vetme, të gjitha formalitetet dhe të sigurojë të gjitha licencat dhe lejet që mund të kërkohen nga çdo autoritet apo ligj për importimin e Kapacitetit në Shqipëri;

- Të transmetojë tek IMOD-i të gjitha dokumentet dhe informacionin e nevojshëm që lidhen me zbatimin e Kontratës, për të mundësuar ofrimin e Mbështetjes nga IMOD-i, sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje Kuadër;

- Çështjet që lindin nga zbatimi i Kontratës, duhet të trajtohen fillimisht në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet ministrive përkatëse të mbrojtjes. Palët do të bëjnë çdo përpjekje për të zgjidhur këto çështje me mirëkuptim dhe mirëbesim, në përputhje me këtë Marrëveshje Kuadër;

- Të nënshkruajë dhe t'i kthejë Furnizuesit Industrial Certifikatën e Përdoruesit Përfundimtar jo më vonë se 2 (dy) javë nga nënshkrimi i Kontratës. Me anë të kësaj Marrëveshjeje, AMOD-i konfirmon dhe deklaron se po e blen kapacitetin vetëm për përdorim përfundimtar nga Forcat e Armatosura të Shqipërisë dhe, se këto të fundit, do të jenë përdoruesi i vetëm përfundimtar i kapacitetit, dhe do ta përdorin atë vetëm për qëllimet e përcaktuara këtu dhe sipas lejeve të vlefshme të eksportit; dhe

- Pa pëlqimin paraprak me shkrim të IMOD-it, të mos e shesë, transferojë, shpërndajë apo në ndonjë mënyrë tjetër të mos e përdorë kapacitetin



dhe/ose ndonjë pjesë të tij dhe/ose ndonjë informacion apo të dhënë në lidhje me kapacitetin (përfshirë, pa kufizim, pjesë, të dhëna teknike etj.) të ndonjë palë e tretë dhe të mos e vendosë kapacitetin në përdorim jashtë Shqipërisë;

- AMOD-i angazhohet se pagesa për mbështetjen e ofruar nga IMOD-i është përfshirë në çmimin e Kontratës, duke qenë në dijeni se mbështetja është llogaritur në përputhje me kohëzgjatjen e Kontratës.

Neni 4

Komiteti i Monitorimit

4.1. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Kuadër (MK), Palët do të krijojnë një **Komitet Monitorimi izraelo-shqiptar (KM)** dhe mund të caktojnë, gjithashtu, një grup pune për të diskutuar dhe rënë dakord mbi projekte të përbashkëta industriale në fushën e mbrojtjes në të ardhmen.

4.2. Përgjegjësitë e tij do të përfshijnë: koordinimin e aktiviteteve të Palëve, siç janë përcaktuar në këtë MK; kërkimin dhe zbatimin e zgjidhjeve specifike të synuara për të zgjidhur çdo problem që mund të lindë gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje Kuadër; dhe sigurimin që vendimet e marra të zbatohen.

4.3. Komiteti i Monitorimit do të mbledhet **një herë në vit**, dhe më shpesh nëse është e nevojshme, në mënyrë alternative në Izrael dhe në Shqipëri.

4.4. Komiteti i Monitorimit do të vlerësojë periodikisht zbatimin e Marrëveshjes Kuadër dhe të Kontratës. Nëpërmjet këtij komiteti të përbashkët, të dyja Palët mund të propozojnë nisma të reja si zbatimin e kapaciteteve mbrojtëse me subjekte të reja shtetërore dhe/ose private nga të dy vendet.

4.5. Pala pritëse përgatit **rendin e ditës** së Komitetit të Monitorimit pas konsultimit me Palën tjetër. Takime shtesë mund të zhvillohen me kërkesë të secilit prej përfaqësuesve të Palëve.

4.6. Çdo Palë do të mbulojë **kostot e udhëtimit**, akomodimit dhe ushqimit për delegacionin e saj që merr pjesë në takimet e zhvilluara në territorin e Palës pritëse. Pala pritëse do të mbulojë të gjitha kostot që lidhen me organizimin e takimeve të Komitetit të Monitorimit.

4.7. Anëtarët e KM-së do të jenë përfaqësues të dyja Palëve. Çdo Palë do të bashkëkryesojë këtë Komitet Monitorimi. Çdo përfaqësues mund të mbështetet nga ekspertë për këshillim mbi çështje

specifike. Bashkëkryesuesit e Komitetit të Monitorimit do të jenë:

- **Për IMOD-in: Drejtori i SIBAT-it**, ose përfaqësuesi i tij/saj i caktuar;

- **Për AMOD-in: Drejtori i Drejtorisë së Politikave të Mbrojtjes (DPD)**, ose përfaqësuesi i tij/saj i caktuar.

4.8. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Kuadër, **pikat e kontaktit** të secilës prej Palëve do të jenë:

- **Për IMOD-in: Drejtori i SIBAT-it** ose përfaqësuesi i tij/saj i caktuar;

- **Për AMOD-in: Drejtori i Drejtorisë së Modernizimit** ose përfaqësuesi i tij/saj i caktuar.

Pikat e kontaktit do të jenë përgjegjëse për organizimin e aktiviteteve të kryera nga Palët në kuadër të kësaj Marrëveshjeje Kuadër.

4.8. Palët mund të ftojnë **Furnizuesin Industrial** dhe **Shoqërinë shqiptare** që të marrin pjesë në të gjitha ose disa prej diskutimeve që zhvillon Komiteti i Monitorimit.

4.9. **Gjuha e punës** e Komitetit të Monitorimit do të jetë **anglishtja**.

Neni 5

Mbrojtja e informacionit të klasifikuar

5.1. Palët bien dakord të shkëmbejnë informacionin e nevojshëm për bashkëpunimin e vendosur nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje Kuadër (MK).

5.2. Secila Palë angazhohet që të mos i zbulojë ndonjë Palë të Tretë asnjë informacion në lidhje me këtë Marrëveshje Kuadër apo me përmbajtjen e saj, përveçse punonjësve të saj, kontraktorëve dhe nënkontraktorëve, vetëm në masën e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve dhe angazhimeve të saj. Kjo Marrëveshje Kuadër dhe çdo informacion, material, njohuri teknike/ekspertizë dhe/ose dokumentacion i dhënë sipas saj, do të trajtohen dhe klasifikohen nga Palët, në përputhje me Aneksin për Sekretin dhe Sigurinë të Kontratës. Çdo publikim i lidhur me këtë Marrëveshje Kuadër është i ndaluar, përveç nëse Palët bien dakord ndryshe.

5.3. Palët bien dakord që nuk do të ndërmerren aktivitete të klasifikuara apo të realizohen transferime informacioni të klasifikuar përpara lidhjes së një marrëveshjeje të ndërsjellë sigurie ndërmjet autoriteteve kompetente, por pa penguar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Kuadër.



5.4. Pavarësisht dispozitave të mësipërme të këtij neni 5, nëse Palët e përfshira kërkojnë financim nga ndonjë ent izraelit, përfshirë Furnizuesin Industrial, në lidhje me Kontratën, AMOD-i konfirmon që IMOD-i dhe/ose Furnizuesi Industrial mund të zbulojnë informacion lidhur me këtë Marrëveshje Kuadër dhe/ose Kontratën ndaj organizatave financiare apo agjencive të sigurimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar tek “Ashra” – Korporata Izraelite për Sigurimin e Eksportit.

Me këtë rast, AMOD-i miraton zbulimin e informacionit për qëllimin e lartpërmendur. Gjithashtu, AMOD-i konfirmon dhe miraton që IMOD-i, nëpërmjet Furnizuesit Industrial, mund të ketë nevojë të zbulojë informacion mbi përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje Kuadër dhe/ose Kontratës, apo detaje të ndonjë aksidenti ose incidenti, që përfshin ndonjë nga kapacitetet ose shërbimet e kryera sipas Kontratës, për qëllime sigurimi ose paraqitjeje kërkesash ndaj siguruesit.

5.5. Çdo Palë do të garantojë që për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Kuadër, aksesit në informacion të kufizohet vetëm për personelin dhe për punonjësit dhe kontraktorët e Furnizuesit Industrial që kanë nevojë të kenë njohuri për përmbushjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Kuadër dhe për informacionin e klasifikuar, për personat që, gjithashtu, janë të autorizuar dhe kanë certifikatë sigurie për akses në informacionin me nivel të krahueshëm klasifikimi.

5.6. I gjithë informacioni i shkëmbyer ndërmjet Palëve sipas kësaj Marrëveshjeje Kuadër, do të jepet dhe përdoret për nevojat e Palëve, në kontekstin e aktiviteteve dypalëshe në fushën e kapaciteteve, siç përcaktohet në këtë Marrëveshje Kuadër.

5.7. Informacioni i shkëmbyer ndërmjet Palëve sipas kësaj Marrëveshjeje Kuadër nuk do të transferohet, komunikohet apo zbulohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, përkohësisht ose përfundimisht, ndaj ndonjë Pale të Tretë, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës origjinuese të informacionit të mësipërm.

5.8. Kjo Marrëveshje Kuadër nuk ndryshon sistemet ekzistuese të pronësisë intelektuale të Palëve, të rregulluara nga legjislacioni i tyre kombëtar, dhe nuk cenon angazhimet ndërkombëtare të ndonjërës Palë.

5.9. Secila Palë do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme ligjore (që mund të përfshijnë procedura kombëtare klasifikimi) për të garantuar që

informacioni i dhënë ose i gjeneruar në bazë të kësaj Marrëveshjeje Kuadër të mbrohet nga çdo rrezik publikimi të mëvonshëm, përveç kur Pala origjinuese e pëlqimit të mësipërm për informacionin, jep pëlqimin për komunikim të mëtejshëm.

5.10. I gjithë informacioni i shkëmbyer nga Palët sipas kësaj Marrëveshjeje Kuadër, do të shënohet në mënyrë të qartë për të treguar origjinën, nivelin e klasifikimit dhe pronësinë e tij.

5.11. Palët nuk do të shesin, japin, transferojnë apo zbulojnë ndaj ndonjë Pale të Tretë ndonjë informacion të marrë në kontekstin e kësaj Marrëveshjeje Kuadër, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës që e ka dhënë fillimisht informacionin.

5.12. Palët mund të rezervojnë të drejtën për të mos zbuluar informacion që lidhet me sistemet e tyre kombëtare.

5.13. Dispozitat e këtij neni do të mbeten në fuqi edhe pas përfundimit ose zbatimit të plotë të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

6.1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve që rrjedh nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje Kuadër (MK) do të zgjidhet vetëm me mjete diplomatike, përmes konsultimit dhe negocimit ndërmjet Palëve, dhe nuk do të nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor apo ankimimit nga ndonjë gjykatë apo tribunal.

6.2. Palët, në radhë të parë, do të bëjnë çdo përpjekje të arsyeshme për të zgjidhur mosmarrëveshjen dhe për të arritur një zgjidhje miqësore në nivelin më të ulët të menaxhimit të mundshëm, brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh. Nëse Palët nuk arrijnë një marrëveshje të tillë, ato bien dakord t’ia paraqesin mosmarrëveshjen për zgjidhje drejtorit të SIBAT-it pranë IMOD-it dhe drejtorit të Përgjithshëm të Politikave të Mbrojtjes pranë AMOD-it. Nëse nuk e zgjidhin mosmarrëveshjen brenda një periudhe shtesë prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, atëherë mosmarrëveshja do t’i paraqitet Sekretarit të Përgjithshëm të AMOD-it dhe drejtorit të Përgjithshëm të IMOD-it, të cilët do të zgjidhin mosmarrëveshjen.

6.3. Çdo vendim i dhënë në përputhje me këtë mekanizëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të



jetë përfundimtar dhe detyrues për Palët e kësaj Marrëveshjeje Kuadër.

6.4. Kjo Marrëveshje Kuadër nuk krijon të drejta ose detyrime ligjore sipas së drejtës kombëtare apo ndërkombëtare.

Neni 7

Afati dhe përfundimi

7.1. Kjo Marrëveshje Kuadër hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit nga dy njoftime ndërmjet Palëve, me të cilin ato informojnë njëra-tjetrën për përmbushjen e kërkesave të tyre të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Kuadër.

7.2. Çdo Kontratë do të hyjë në fuqi vetëm pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Kuadër.

7.3. Kjo Marrëveshje Kuadër mund të ndryshohet në çdo kohë, në bazë të pëlqimit me shkrim ndërmjet Palëve.

7.4. Afati i kësaj Marrëveshjeje Kuadër do të vazhdojë deri në përfundimin e plotë të angazhimeve të Palëve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.

7.5. Nëse ndonjë nga Palët dëshiron të ndërpresë këtë Marrëveshje Kuadër përpara skadimit të saj, duhet të dërgojë një njoftim me shkrim për qëllimin e ndërprerjes Palës tjetër, 6 (gjashtë) muaj përpara datës së synuar të ndërprerjes/përfundimit. Ky njoftim synimi do të shërbejë si bazë për konsultime ndërmjet Palëve, me qëllim që Pala tjetër të vlerësojë plotësisht pasojat e kësaj ndërprerjeje dhe në frymën e bashkëpunimit, të ndërmerren veprimet e nevojshme për të zbutur problemet e mundshme që rrjedhin nga një ndërprerje e tillë e parakohshme. Çdo ndërprerje do të përcaktohet me pëlqimin unanim me shkrim të Palëve.

7.6. Ndërprerja e kësaj Marrëveshjeje Kuadër nuk lehtëson Palët nga detyrimet e kontraktuara gjatë periudhës të vlefshmërisë së saj.

Kjo Marrëveshje Kuadër nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale, secila në gjuhën angleze, me vlefshmëri të barabartë ligjore.

Në dëshmi të sa më sipër, Palët kanë vendosur nënshkrimet e tyre në Tiranë, më 30.7.2025, si më poshtë:

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, I PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E MBROJTJES E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Mbrojtjes

Gjergji Methoxha

Nënshkrimi

QEVERIA E SHTETIT TË IZRAELIT, E PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E MBROJTJES E SHTETIT TË IZRAELIT

Drejtori i SIBAT-it

Yair Kulas

VENDIM

Nr. 499, datë 10.9.2025

PËR MIRATIMIN E LETËRMARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “PËRMIRËSIMI I PRAKTIKAVE TË KONTABILITETIT DHE RAPORTIMIT TË SEKTORIT PUBLIK NË SHQIPËRI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e letërmarrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Përmirësimi i praktikave të kontabilitetit dhe raportimit të sektorit publik në Shqipëri”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



XIAOQING YU

Drejtore Rajonale, Ballkani Perëndimor

Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

1 prill 2025

SH. T. Z. Petrit Malaj

Ministër i Financave

Ministria e Financave

Tiranë

Republika e Shqipërisë

Lënda: Granti nr. TF0C7858

Përmirësimi i Praktikave të Kontabilitetit dhe

Raportimit të Sektorit Publik në Shqipëri

Letërmarrëveshje

Shkëlqesi:

Në përgjigje të kërkesës për ndihmë financiare, të bërë në emër të Republikës së Shqipërisë (“Përfituesi”), kam kënaqësinë t’iu informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (“Banka”) që vepron si administratore e Fondit të Besimit për Menaxhimin Financiar me Donator të Vetëm të SECO-s, propozon t’i japë Përfituesit një grant në një shumë që nuk duhet të tejkalojë një milion e dyqind mijë dollarë amerikanë (1,200,000 USD) (“Granti”) sipas termave dhe kushteve të përcaktuara ose të referuara në këtë letërmarrëveshje (“Marrëveshja”), e cila përfshin aneksin bashkëlidhur, për të asistuar në financimin e Projektit të përshkruar në aneks (“Projekti”).

Ky Grant financohet nga fondi i lartpërmendur i besimit për të cilin Banka merr kontribute periodike nga donatori për fondin e besimit. Në përputhje me seksionin 3.02 të kushteve standarde (siç përcaktohen në aneksin e kësaj Marrëveshjeje), detyrimet e Bankës për kryerjen e pagesës në lidhje me këtë Marrëveshje janë të kufizuara në shumën e fondeve të vëna në dispozicion të saj nga donatori nën fondin e lartpërmendur të besimit, dhe e drejta e Përfituesit për të tërhequr të ardhurat e Grantit është objekt i disponueshmërisë së këtyre fondeve.

Përfituesi përfaqëson, duke konfirmuar dakordësinë e tij më poshtë, se është i autorizuar të lidhë këtë Marrëveshje dhe të zbatojë Projektin në

përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara ose të referuara në këtë Marrëveshje.

Ju lutem, konfirmoni dakordësinë e Përfituesit për sa më sipër, duke nënshkruar dhe vendosur datën në këtë Marrëveshje nëpërmjet një zyrtari të autorizuar nga Përfituesi dhe kthimin e një kopje të nënshkruar Bankës.

Me respekt,

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR

RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR

ZHVILLIM (duke vepruar si administrator i

Fondit të Besimit për Menaxhimin Financiar me

Donator të Vetëm të SECO-s)

Nga (nënshkrimi)

Xiaoqing Yu

Drejtore Rajonale

Zyra e Bankës Botërore në Vjenë

RËNË DAKORD:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: NËNSHKRIMI

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: PETRIT MALAJ

Titulli: MINISTRI I FINANCIVE

Data: 29.7.2025

Bashkëlidhur:

1. “Kushtet standarde të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim për Financimin e Granteve të Ofruara nga Banka nga Fondet e Besimit”, datë 25 shkurt 2019.

2. Letra e disbursimit dhe informacionit financiar të së njëjtës datë me këtë Marrëveshje, së bashku me “Udhëzimet e disbursimit për financimin e projekteve të investimeve”, e shkurtit 2017.

Granti nr. TF0C7858

ANEKS

Neni I

Kushtet standarde; përkufizimet

1.01 **Kushtet standarde.** Kushtet standarde (siç përcaktohen në seksionin 1.02 më poshtë) përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.



1.02 **Përkufizimet.** Përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, termit me shkronjë të madhe në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u janë dhënë në Kushtet Standarde ose në këtë seksion:

a) “Udhëzime antikorruption” nënkupton, për qëllimet e paragrafit 2 të shtojcës së kushteve standarde, “Udhëzimet për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga huat e BNRZH-së dhe kreditë dhe grantet e IDA-s”, të datës 15 tetor 2006 dhe të rishikuara në janar 2011, dhe më 1 korrik 2016.

b) “Kategori” nënkupton një kategori të përcaktuar në tabelën në seksionin 3.01 të kësaj Marrëveshjeje.

c) “CSAP” ose “Strategji Kombëtare dhe Plan Veprimi” nënkupton planin e veprimit në lidhje me Kontabilitetin e Sektorit Publik, të miratuar nga Përfituesi në vitin 2019, për të shërbyer si udhërrëfyesi kryesor për transformimin e sistemit kombëtar të KSP-së drejt kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara (baza akruale).

d) “Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit” nënkupton strukturën përgjegjëse në MF për harmonizimin e standardeve, rregulloreve dhe procedurave për ekzekutimin, monitorimin dhe raportimin e menaxhimit financiar, kontrollit dhe kontabilitetit në sektorin publik.

e) “Plan i Angazhimit Mjedisor dhe Social” ose “ESCP” nënkupton planin e angazhimit mjedisor dhe social për Projektin, të datës 25 mars 2025, siç mund të ndryshohet herë pas here në përputhje me dispozitat e tij, i cili përcakton masat materiale dhe veprimet që Përfituesi duhet të zbatojë ose do të kërkojë të zbatohen për të trajtuar rreziqet dhe ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale të Projektit, duke përfshirë afatet kohore të veprimeve dhe masave, angazhimet institucionale, të stafit, trajnimit, monitorimit dhe raportimit, si dhe çdo instrument mjedisor dhe social që do të përgatitet më pas.

f) “Standardet mjedisore dhe sociale” ose “ESS” nënkupton të gjitha standardet së bashku si në vijim: (i) “Standardi mjedisor dhe social 1: Vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale”; (ii) “Standardi mjedisor dhe social 2: Puna dhe kushtet e punës”; (iii) “Standardi mjedisor dhe social 3: Eficienca e burimeve dhe parandalimi dhe menaxhimi i ndotjes”; (iv) “Standardi mjedisor dhe social 4: Shëndeti dhe siguria e komunitetit”; (v)

“Standardi mjedisor dhe social 5: Blerja e tokës, kufizimet në përdorimin e tokës dhe zhvendosja e detyruar”; (vi) “Standardi mjedisor dhe social 6: Ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve të gjalla natyrore”; (vii) “Standardi mjedisor dhe social 7: popujt indogjenë/komunitetet lokale tradicionale historikisht të nënshërbyera të Afrikës Nënshahiane”; (viii) “Standardi mjedisor dhe social 8: Trashëgimia kulturore”; (ix) “Standardi mjedisor dhe social 9: Ndërmjetësit financiarë”; (x) “Standardi mjedisor dhe social 10: Angazhimi i palëve të interesuara dhe shpërndarja e informacionit”, në fuqi nga data 1 tetor 2018, sipas publikimit të Bankës.

g) “GDFC” ose “Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontrakteve” nënkupton strukturën e MF-së të ngarkuar me aspektet fiduciare për zbatimin e Projektit.

h) “Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit” nënkupton strukturën e MF-së, siç referohet në seksionin 2.03 (a) të këtij aneksi.

i) “MF” nënkupton Ministrinë e Financave të Përfituesit, ose çdo pasues të saj.

j) “Kosto operative” nënkupton shpenzimet e arsyeshme shtesë operative të bëra drejtpërdrejt nga Përfituesi për zbatimin, menaxhimin dhe monitorimin e Projektit, duke përfshirë shpenzimet për komunikimet, shërbimet e përkthimit dhe interpretimit, tarifat bankare, pajisjet e zyrave, reklamat, konferencat, seminarët, shpërndarjen e informacionit lidhur me projektin, qiratë dhe shërbimet utilitare të zyrës, sigurimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve të zyrave, raportimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve, udhëtimet, sigurinë, si dhe kosto të tjera të ndryshme që lidhen drejtpërdrejt me Projektin, por duke përjashtuar pagat e nëpunësve civilë të Përfituesit.

k) “MFP” nënkupton menaxhimin e financave publike.

l) “Rregullat e prokurimit” nënkupton, për qëllime të paragrafit 2.0 të shtojcës së kushteve standarde, “Rregullat e prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e FPI-së”, shtator 2023.

m) “Ekip i Zbatimit të Projektit” ose “PIT” nënkupton njësinë që do të krijohet nga Përfituesi në përputhje me seksionin 2.03 (a) të aneksit të kësaj Marrëveshjeje, ose çdo pasues të saj, që konsiderohet i pranueshëm nga Banka, me qëllim ofrimin e mbështetjes dhe koordinimit në menaxhimin e Projektit.



n) “Manual i Operacioneve të Projektit” nënkupton manualin e Përfituesit të pranueshëm nga Banka, të referuar në seksionin 2.03 (d) të aneksit të kësaj Marrëveshjeje, siç ky manual mund të ndryshohet herë pas here me miratimin paraprak të Bankës.

o) “Komitet Drejtues i Projektit” nënkupton komitetin e referuar në seksionin 2.03 (c) të aneksit të kësaj Marrëveshjeje.

p) “KSP” ose “Kontabiliteti i Sektorit Publik” nënkupton sistemin e kontabilitetit të sektorit publik të Përfituesit.

q) “Kushte standarde” nënkupton “Kushtet standarde të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim për Financimin e Granteve të Ofruara nga Banka nga Fondet e Besimit”, datë 25 shkurt 2019.

r) “Trajnim” nënkupton shpenzimet (përveç atyre për shërbimet e konsulentëve) e kryera për trajnime dhe aktivitete të lidhura me trajnimet në kuadër të Projektit, duke përfshirë shpenzimet për seminare, takime pune dhe vizita studimore, udhëtime, akomodim dhe dieta për pjesëmarrësit në trajnime, pagesa për trajnerët, marrjen me qira të ambienteve të trajnimit, përgatitjen dhe riprodhimin e materialeve të trajnimit, si dhe aktivitete të tjera ndihmëse të lidhura me përgatitjen dhe zbatimin e aktiviteteve të trajnimit.

s) “TVSH” nënkupton tatimin mbi vlerën e shtuar.

Neni II Ekzekutimi i Projektit

2.01 *Objektivat dhe Përshkrimi i Projektit.*

Objekti i Projektit është përmirësimi i praktikave të raportimit financiar dhe kontabilitetit të sektorit publik në qeverisjen qendrore. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1. Aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve

Mbështetja e stafit të kontabilitetit, financave dhe auditimit të institucioneve të qeverisë qendrore të Përfituesit nëpërmjet ofrimit të aktiviteteve të trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve, duke u fokusuar në: (a) zhvillimin dhe zbatimin e një programi trajnimi dhe komunikimi bazuar në kërkesat e kuadrit të ri të KSP-së që përfshin politikën, procedurat dhe proceset e KSP-së; (b) forcimin e kapaciteteve teknike të MF-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit për zbatimin

e Projektit; dhe (c) institucionalizimin e programeve të trajnimit të KSP-së.

Pjesa 2. Zbatimi gradual i Kuadrit të KSP-së në përputhje me SNKSP-në

Ofrimi i mbështetjes për MF-në dhe institucionet e qeverisë qendrore të Përfituesit për zbatimin gradual të Kuadrit të KSP-së, përgatitjen e bilancit të hapjes dhe të pasqyrave financiare të ndërmjetme në përputhje me qëllimin e CSAP-së së rishikuar.

Pjesa 3. Zbatimi i menaxhimit të ndryshimeve dhe menaxhimi i Projektit

Ofrimi i mbështetjes për: (a) zbatimin e menaxhimit të procesit të ndryshimeve nëpërmjet kryerjes së fushatave të informimit dhe komunikimit që synojnë grupe të ndryshme interesi, përfshirë stafet e kontabilitetit, financave, auditimit, deputetë të Kuvendit dhe drejtues të lartë; (b) Ekipin e Zbatimit të Projektit dhe GDFC-në për menaxhimin e Projektit, koordinimin, prokurimin dhe menaxhimin financiar, si dhe monitorimin dhe vlerësimin; dhe (c) Aktivitetet e trajnimit dhe ndërtimit të kapaciteteve të lidhura me Projektin.

2.02 *Ekzekutimi i Projektit në Përgjithësi.* Përfituesi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivit të Projektit. Për këtë qëllim, Përfituesi do të zbatojë Projektin në përputhje me dispozitat e: (a) nenit II të kushteve standarde; (b) udhëzimet antikorrupsion; dhe (c) këtij neni II.

2.03. *Marrëveshje Institucionale dhe të Tjera.* Pa kufizime ndaj dispozitave të seksionit 2.02 më sipër:

a) Përfituesi, nëpërmjet MF-së, do të ngrejë dhe më pas do të mbajë gjatë gjithë periudhës së zbatimit të Projektit, një ekip të përbërë në çdo kohë nga personel i kualifikuar dhe sipas termave të referencës dhe funksioneve të pranueshme nga Banka, i cili do të jetë përgjegjës për menaxhimin dhe koordinimin e përditshëm të Projektit (“Ekipi i Zbatimit të Projektit” ose “EZIP”). Për këtë qëllim: (i) EZIP do të përbëhet, ndër të tjera, nga zyrtarë të Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit, Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe njësi të tjera të lidhura me menaxhimin e reformës së MFP-së dhe projektet e financuara nga donatorët; dhe (ii) Përfituesi do të punësojë, jo më vonë se 1 (një) muaj pas datës së hyrjes në Fuqi, një ekspert lokal si pikë fokale për çështje mjedisore dhe sociale, me kualifikimet e duhura dhe sipas kushteve të referencës të pranueshme për Bankën, për të mbështetur Ekipin e Zbatimit të Projektit.



b) Përfituesi, nëpërmjet MF-së, do të garantojë që GDFC-ja të jetë struktura përgjegjëse për aspektet fiduciare të zbatimit të Projektit, duke përfshirë menaxhimin financiar dhe prokurimin.

c) Përfituesi, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të Projektit, do të ketë një Komitet Drejtues të Projektit i cili do të jetë përgjegjës për: (i) mbikëqyrjen e zbatimit të Projektit; (ii) ofrimin e udhëzimeve të politikave; (iii) monitorimin e progresit; dhe (iv) sigurimin e koordinimit të palëve të interesuara.

d) Përfituesi, nëpërmjet MF-së, do të zbatojë Projektin në përputhje me Manualin e Operacioneve të Projektit, duke përfshirë, *ndër të tjera*: (i) marrëveshjen për menaxhimin financiar dhe disbursimin sipas Projektit; (ii) procedurat e prokurimit, dokumentacionin standard të prokurimit dhe procedurat e administrimit dhe menaxhimit të kontakteve; (iii) administrimin institucional, koordinimin dhe zbatimin e përditshëm të Projektit; (iv) monitorimin dhe vlerësimin; (v) raportimin; (vi) aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve, duke përfshirë trajnimin; dhe (vii) masa dhe procedura të tjera teknike dhe organizative që do të kërkohen për Projektin.

e) Përfituesi nuk do të caktojë, ndryshojë, shfuqizojë ose heqë dorë ose lejojë që të caktohet, ndryshohet, shfuqizohet ose hiqet dorë nga Manuali i Operacioneve të Projektit ose ndonjë dispozitë e tij, në një mënyrë që, sipas opinionit të Bankës, mund të ndikojë materialisht dhe negativisht në zbatimin e Projektit.

2.04 Standardet mjedisore dhe sociale

a) Përfituesi do të garantojë që Projekti të zbatohet në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale, në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

b) Pa kufizim në paragrafin “a” më sipër, Përfituesi do të garantojë që Projekti të zbatohet në përputhje me Planin e Angazhimit Mjedisor dhe Social (“ESCP”), në një mënyrë të pranueshme për Bankën. Për këtë qëllim, Përfituesi duhet të garantojë që:

i. masat dhe veprimet e specifikuar në ESCP të zbatohen me kujdesin e duhur dhe në mënyrë efikase, siç parashikohet në ESCP;

ii. të ketë në dispozicion fonde të mjaftueshme për të mbuluar kostot e zbatimit të ESCP-së;

iii. të ketë politika dhe procedura dhe numër të mjaftueshëm të personelit të kualifikuar dhe me

përvojë për të zbatuar ESCP-në, siç parashikohet në ESCP; dhe

iv. të mos ndryshohet, shfuqizohet, pezullohet ose hiqet dorë nga ESCP-ja ose ndonjë dispozitë e tij, përveç rasteve kur Banka bie dakord ndryshe me shkrim, siç specifikohet në ESCP, dhe të sigurojë publikimin e menjëhershëm të ESCP-së së rishikuar.

c) Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet ESCP-së dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

d) Përfituesi do të garantojë që:

i. të merren të gjitha masat e nevojshme për të mbledhur, hartuar dhe vënë në dispozicion të Bankës, nëpërmjet raporteve të rregullta, sipas periodicitetit të specifikuar në ESCP, dhe menjëherë në një raport ose raporte të veçanta, nëse kjo kërkohet nga Banka, informacion mbi statusin e përputhshmërisë me ESCP-në dhe instrumentet mjedisore dhe sociale të referuara në të, ku të gjitha këto raporte në formë dhe përmbajtje të jenë të pranueshme për Bankën, duke përcaktuar, ndër të tjera: (A) statusin e zbatimit të ESCP-së; (B) kushtet, nëse ka, që ndërhyjnë ose rrezikojnë të ndërhyjnë në zbatimin e ESCP-së; dhe (C) masat korrigjuese dhe parandaluese që merren ose që duhet të merren për të trajtuar këto kushte; dhe

ii. Banka të njoftohet menjëherë për çdo incident ose aksident që lidhet ose ka ndikim në Projekt, i cili ka ose mund të ketë ndikim negativ të konsiderueshëm në mjedis, komunitetet e prekura, për publikun ose punëtorët, në përputhje me ESCP-në, instrumentet mjedisore dhe sociale të referuara në të dhe Standardet Mjedisore dhe Sociale.

f) Përfituesi do të krijojë, publikojë, mirëmbajë dhe operojë një mekanizëm të aksesueshëm për ankesat, për të marrë dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të personave të prekur nga Projekti, dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të zgjidhu ose lehtësuar zgjidhjen e këtyre shqetësimeve dhe ankesave, në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

